



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:294185

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520505

**C.nr.5072/2023**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – **Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**, me gjyqtaren Njomëza Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.Th. nga Prizreni, kundër të paditurës P.K. – Drejtoria e Përgjithshme, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimi i pagës së trembëdhjetë, vlera e kontestit 531.90 €, jashtë seancës, me datë 28.03.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D.K. nga Prizreni.
- II. DETYROHET** e paditura P.K. - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitin 2021 t'ia paguajë shumën në lartësi prej 531.90 €, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (22.12.2023) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 124 € (njëqind e njëzet e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi D.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate përmes të autorizuarit të saj av. A.Th. ka parashtruar padi kundër të paditurës P.K. të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e pagës së trembëdhjetë.

Në padi ka theksuar se paditësi te e paditura është në marrëdhënie pune nga data 16.01.2006, dhe në bazë të rregullativës ligjore në fuqi, përkatësisht Ligjin e Punës nr.03/L-2012, nenet 55 dhe 95, Ligjin për Policinë e Kosovës, nenet 44 dhe 55, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.04/2017 dhe Nr.02/2018 i datës 14.11.2018, mbi Marrëdhënien e punës në P.K. të njëjtit i takon shpërblimi i një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt në fund të vitit bazuar në vlerësimet e performancës së punës, ku paditësi e ka plotësuar këtë kusht, respektivisht ka treguar performancë shumë të mire gjatë vitit 2021. Ashtu nga gjykata ka kërkuar që ta obligoj të paditurën – P.K. që në emër të kompensimit të pagës së 13 për vitin 2021 të ia paguaj shumën në lartësi prej 531.90 € duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8%

nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi të paraqitur në gjykatës nëpërmjet të autorizuarës së saj Avokatura Shtetërore me seli në Prishtinë ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të palejuar, gjegjësisht të pas afatshme për shkak të mos shterjes së procedurave të brendshme nga paditësi tek e paditura si dhe skadimit të afatit të paraqitjes së padisë nga paditësi. I ka propozuar gjykatës që të vendosë pa shqyrtim për shkak të rritjes së shpenzimeve procedurale. Për sa u përket kompensimit të pagës së trembëdhjetë dhe shujtave e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare, nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Në fund ka shtuar sa i përket kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së 13-të, shujtave, për çdo vit kalendarik e kundërshtojmë pasi që kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim i të paditurës. E paditura ndaj paditësit të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e kontratës së Punës e cila konsiderohet ligj për palët. Paditësi do të mund të kompensohet për pagën e 13-të, brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare", andaj deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar, që nënkupton se nuk është detyrim për të paditurën. Gjithashtu është thirr në parashkrimin e kërkesës në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës. Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave, të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e bazuar, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata përmes vërtetimit të punësimit me numër të referencës Nr. 04/1-04 SRR-A/849/2021 të datës 17.08.2021, vërtetoi faktin se paditësi për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 531.90 € në muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin 2021 gjykata vërtetoi faktin se paditësi për vitin 2021 ka pasur vlerësim të përgjithshëm, me notën 4, që korrespondon me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm.

Vërtetimin si dhe formularët e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se

*“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj vërtetimit me të cilin është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës lartësia e pagës është 531.90 Euro dhe formularëve me të cilin është bërë vlerësimi i punës së paditësit për vitin kalendarik 2021 gjykata ia fali besimin e plotë.*

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës.

Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*. Në nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*. Ndërsa neni 55 par.1 nënpar.1.7 i këtij Ligji përcakton se: *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*. Në nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*. Ndërkaq në nenin 29 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”,* ndërkaq bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës është paraparë se *“në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13 për çdo fund vit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ

Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht vlerësimi për vitin 2021 ka qenë plotësisht i kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Pretendimin për parashkrimin e kërkesës, gjykata e vlerësoi por erdhi në përfundim se është i pabazuar sepse konform nenit 87 të Ligjit të Punës, kërkesat në para nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej 3 viteve, në këtë drejtim, kërkesa i referohet pagës së 13-të për vitin 2021, padia është paraqitur me datë 22.12.2023 dhe si e tillë është brenda afatit prej 3 viteve.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në pikën II të dispozitivit, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (22.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumë prej 104 euro dhe taksës gjyqësore shumë prej 20 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme 124 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 dhe nenit 398 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.5072/2023, datë 28.03.2024**

**B. profesionale**  
**Delvina Ajazaj**

**Gjyqtarja**  
**Njomëza Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.